

KFOR-i: Grupet kriminale kanë qenë mbrapa protestave të dhunshme në Zveçan



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SA DRAFT-STATUTE JANË HARTUAR PËR ASOCIACIONIN?




Për jetësimin e Marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilën Prishtina dhe Beogradi e arritën dhjetë vjet më parë, aktualisht ekzistojnë katër draft-statute dhe

draft-vizione. Bashkësia ndërkombëtare insiston që Kosova ta themelojë Asociacionin i cili do të mbledhte rreth vetes komunat në Kosovë të banuara me shumicë serbe dhe themelimi i tij, nga

faktori ndërkombëtar, është parë si "kusht mbi kushtet" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e raporteve që ndërmjetësohet nga blloku evropian


AKTUALE



MAVRAJ: NË PLAN KUSHTETUES, SHQIPËRIA E KA PËR DETYRË TË INTERESOHET PËR TË DREJTAT KOMBËTARE KUDO F. 5

HILL: KEMI PROBLEME SHUMË THELBËSORE ME KURTIN F. 5

SOT NË SHTËPINË E ATDHETARIT TË ÇËSHTJES KOMBËTARE, SHASIVAR MAKOLLI, DO TË VENDOSËT PLLAKË PËRKUJTIMORE F. 6



EKONOMI

NDALOHEN PESË PERSONA TË DYSHUAR PËR KONTRABANDIM TË MALLRAVE DHE ARTIKUJVE TË DËMSHËM USHQIMORË F. 8

A U RRIËN SËRISH NORMAT E INTERESIT TË KREDIVE? F. 8

SPORT



GIRESSE: DUHET FOKUS MAKSIMAL PËR TË MARRË MAKSIMUMIN F. 12

LIMAJ: REZOLUTA 1244 PO RIAKTUALIZOHET NË VERI

FAQE 3



ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE KUNDËRSHTOJNË PROJEKTLIGJIN PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi paditet lidhur me rastin e dokumenteve të klasifikuara

WASHINGTON, 9 QERSHOR - Ish-presidenti amerikan Donald Trump është paditur për mënyrën se si i ka menaxhuar dokumentet e klasifikuara pasi është larguar nga Shtëpia e Bardhë. Trumpi, 76-vjeçar, përballet me shtatë akuza, përfshirë mbajtjen e paautorizuar të dokumenteve të klasifikuara, kanë thënë mediet amerikane. Padia ndaj tij nuk është bërë ende publike. Kjo është padia e dytë që rëndon ndaj Trumpit dhe e para padie federale ndonjëherë për ish-president të ShBA-së. Aktualisht Trumpi është duke bërë fushatë me synimin për të fituar edhe një mandat presidencial në Shtëpinë e Bardhë. Ekspertë ligjorë besojnë se padia nuk do ta kufizojë mundësinë e Trumpit për të garuar sërish për president.

Në një postim në platformën e tij sociale, "Truth Social", Trump ka thënë se është i pafajshëm dhe se i është kërkuar të dalë para një gjykate federale në Majami të Floridas në pasditen e së martës, kur do të arrestohet dhe do t'i lexohen akuzat. "Nuk e kam menduar kurrë që mund t'i ndodhë diçka e tillë një ish-presidenti të Shteteve të Bashkuara", ka thënë ai. "Kjo është ditë e zezë për Shtetet e Bashkuara. Ne jemi shtet në rënie të shpejtë dhe serioze, mirëpo së bashku do ta bëjmë Amerikën të mrekullueshme sërish". Avokati i Trumpit, Jim Trusky, ka thënë për rrjetin televiziv CNN, se ish-presidenti i ka pranuar hollësitë e akuzave përmes një dokumenti. Ai ka thënë se aty përfshihen akuza për komplot, deklarata të rreme, pengim të drejtësisë dhe posedim të paligjshëm të dokumenteve të klasifikuara, sipas Aktit të



Spiunazhit.

Departamenti amerikan i Drejtësisë nuk ka pranuar ta komentojë këtë rast, dhe padia nuk është bërë publike.

Padia është dokument që

përbëhet nga akuzat kundër një personi.

Shërbimi Sekret do të takohet me stafin e Trumpit dhe zyrtarët e tij të sigurisë për ta planifikuar udhëtimin në gjykatën në

Majami.

Sondazhet publike tregojnë se Trumpi është në krye të garës në mesin e republikanëve për ta fituar nominimin e partisë për të garuar për president.

Erdogani emëron një grua në krye të Bankës Qendrore



STAMBOLL, 9 QERSHOR - Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan e ka emëruar të premten Hafize Gaye Erkanin, ish-zyrtare ekzekutive për financa në Shtetet e Bashkuara, guvernatore të Bankës Qendrore. Ajo do të përballet me një prej normave më të larta të inflacionit.

Erkan - ish-bashkëudhëheqëse e Bankës Republika e Parë dhe drejtoreshë menaxhuese e Goldman Sachs në ShBA - do të

jetë gruaja e parë që do të jetë në krye të Bankës Qendrore në Turqi. Erdogan, i cili sapo e ka nisur mandatin e tretë të presidentit, e ka paraqitur të shtunën kabinetin e ri qeveritar.

Ministër i Financave është emëruar Mehmet Simsek.

Simsek, i cili ka punuar ministër i Financave dhe zëvendëskryeministër edhe në qeveritë e kaluara, njihet për qasjen kundër politikave

jokonvencionale të Erdoganit për ulje të normave të interesit me qëllim të luftimit të inflacionit. Deri më tani atë detyrë e ka mbajtur Sahap Kavcioglu. Nën menaxhimin e Kavcioglut, norma e interesit është ulur në 8.5 për qind.

Më 2021 norma ka arritur në 19 për qind. Shkalla e inflacionit ka rënë nën 40 për qind në Turqi, në maj, për herë të parë në 16 muaj.

Vazhdojnë sulmet ukrainase në rajonin kyç jugor

KIEV, 9 QERSHOR - Sulmet ukrainase në rajonin jugor të Zaporizhjas janë duke vazhduar, kanë thënë zyrtarë rusë dhe blogerë ushtarakë pro Kremilit. Ata janë duke raportuar për luftime të ashpra në atë zonë. Sipas tyre, trupat ushtarake ukrainase - të përkrahura nga tanket, artileria dhe dronët - janë duke tentuar të avancojnë në jug të qytetit Orikhiv për të dytën natë me radhë. Një zyrtar i lartë ukrainas ka thënë se armiku është në "mbrojtje aktive". Disa ekspertë ushtarakë kanë thënë se fokusi i kundëroffensivës së shumëpritur ukrainase do të jetë në Zaporizhja. Ata argumentojnë se Kievi është duke tentuar ta rikthejë qasjen në Detin Azov për t'i ndarë forcat pushtuese ruse në atë rajon në dy grupe. Diçka e tillë jo vetëm që do t'i dobësonte kapacitetet

ushtarake të Rusisë, por edhe do t'ia eliminonte qasjen në urën që çon në Krime - gadishullin ukrainas të aneksuar nga Rusia më 2014.

Më herët gjatë së enjtes, Instituti për Studime të Luftës, me bazë në ShBA, ka thënë se kundëroffensiva ukrainase ka nisur, ndonëse Kievi nuk konfirmon diçka të tillë. Ndërkohë, Ministria e Mbrojtjes e Britanisë ka thënë se luftime të ashpra janë duke u zhvilluar në disa fronte të luftës. Sipas saj, "në shumicën e zonave iniciatore është Ukraina".

Rusia e ka pushtuar pjesën më të madhe të rajonit Zaporizhja - përfshirë edhe centralin më të madh bërthamor të Evropës - pak pasi presidenti rus Vladimir Putin ka dhënë urdhër për nisje të luftës në shkurt të vitit 2022.

Kryeqyteti rajonal, qyteti i Zaporizhjas, kontrollon nga



Ukraina.

Ukraina është duke e planifikuar kundëroffensivën që disa muaj, mirëpo ka pritur sa më shumë që ka qenë e mundur, për t'i trajnuar trupat ushtarake dhe për të pranuar pajisje të avancuara ushtarake nga aleatët perëndimorë.

Muajin e kaluar Oleksiy Danilov, sekretar i Këshillit për Siguri Kombëtare dhe Mbrojtje të Ukrainës, ka thënë se Kievi është i gatshëm ta nisë kundëroffensivën, por pa përmendur ndonjë datë specifike.

Presidenti rus Vladimir Putin e

quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Përfundimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Limaj: Rezoluta 1244 po riaktualizohet në veri

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Rezoluta 1244, sipas kryetarit të Nismës Socialdemokrate, është duke u riaktualizuar në veri të Kosovës e, sipas tij, fajtor është kryeministri Albin Kurti për shkak të politikave të tij të gabuara. Limaj në "Debat Plus" në RTV Dukagjini ka theksuar se rikthimi i kësaj rezolute është platformë ruso-serbe. "Deklaratat e Daçiqit dhe Lavrovit thonë se objektivi është të kthehet rezoluta 1244 në Kosovë. Kjo është platformë ruso-serbe, pra rikthimi i rezolutës po riaktualizohet në veri. Pamjet e KFOR-it flasin vetë. Me çfarë autorizimi hyn KFOR-i në Mitrovicë, vetëm me Rezolutë 1244", ka thënë ai. Limaj ka përmendur edhe ditën e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 ku, sipas tij, emisari i UNMIK-ut ka pasur të drejtë ta shpallë pavarësinë të pavlefshme por që, sipas tij, këtë gjë nuk e kanë lejuar miqtë ndërkombëtarë të Kosovës. Ai ka theksuar se Kosova është më e madhe sesa marrëdhëniet personale të Kurtit. "Nuk jam i shqetësuar me marrëdhëniet personale në mes të Ramës dhe

Albinit. Gjë e parëndësishme. Kosova është më e madhe se Rama e Kurti. Marrëdhëniet personale nuk guxojnë të na bëjnë të mendojmë diçka. S'ka për të shkuar muaji ata do të përqafohen, por plagët e marrëdhënies mbasin", ka thënë Limaj në pyetjen e analistëve se si i sheh raportet e Kurtit me Ramën pas propozimit të këtij të fundit për një draft-dokument të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Limaj ka thënë se Rama nuk është dashur ta dërgojë draftin e Asociacionit pa i konsultuar krerët e Kosovës. "Rama nuk është dashur ta bëjë dërgimin e draftit në ato adresa pa u konsultuar me shtetin e Kosovës. Për shkak të marrëdhënies Kosovë - Shqipëri, është dashur t'i njoftojë krerët shtetërorë", është shprehur Limaj. Ai i ka akuzuar pozitën dhe opozitën në Kosovë se nuk "po e kuptojnë se në çfarë situatë është vendi". Limaj ka vënë në dyshim deklaratimet e opozitës, duke pyetur se çfarë shpjegimi kanë ata për qytetarët përveçse të mos pajtohen. Ai e ka vlerësuar këtë si një mangësi në



përkushtimin e tyre për t'ua shpjeguar qytetarëve pse ata qëndrojnë kundër politikave të qeverisë aktuale. "Qytetarët e Kosovës gati janë duke u bërë indiferentë nga sjellja e kësaj

politike. Detyra e opozitës është të japë shpjegime. Cili është shpjegimi i saj? Çfarë shpjegimi ka, përveç nuk pajtohet me deklaratat se 'po na prishin marrëdhëniet me

ndërkombëtarët' dhe mbaroi filmi. Ti çfarë roli ke? Çfarë po bën ti që mos të prishen marrëdhëniet e Kosovës me ndërkombëtarët?", ka theksuar Limaj.

KFOR-i: Grupet kriminale kanë qenë mbrapa protestave të dhunshme në Zveçan

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Zëdhënësi i KFOR-it në Kosovë, koloneli Andrea Gallieni, ka thënë se disa grupe kriminale kanë qenë mbrapa protestave të dhunshme që janë zhvilluar në Zveçan më 29 maj. Atë ditë protestuesit serbë janë përleshur me pjesëtarë të KFOR-it dhe të plagosur ka pasur prej të dyja anëve. Në një konferencë për medie të premtuar, Gallieni i ka komentuar ngjarjet që kanë ndodhur në veri të Kosovës prej 29 majit. "Është shumë e rëndësishme që të gjitha palët të përmbahen nga veprimet hakmarrëse sepse, siç e kanë dëshmuar edhe këto ngjarje, gjithçka mund të përshkallëzohet në nivel të madh të dhunës, prandaj është shumë e rëndësishme që të



gjitha palët t'i kenë parasysh pasojat dhe rreziqet e veprimeve

të tyre". Ai ka thënë se të dyja palët duhet

të mbajnë përgjegjësi. Njëra palë, për marrjen e

vendimeve, pa e marrë parasysh shkallën e sigurisë, dhe pala tjetër të reagojë për veprimet e dhunshme që janë parë në mesin e protestuesve. Serbët lokalë janë duke vazhduar protestat në tri komunat në veri të Kosovës, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, edhe më 9 qershor. Ata po protestojnë rregullisht për ta kundërshtuar hyrjen e kryetarëve shqiptarë në ndërtesat komunale. Zyrta i KFOR-it ka thënë se prej 5 qershorit mbi 500 pjesëtarë të NATO-s kanë shkuar në Kosovë për ta përforcuar misionin. Gallieni ka thënë se forcat janë duke u trajnuar dhe do të angazhohen brenda disa ditësh. Ai ka thënë se përforcimet do të jenë në Kosovë "aq sa të ketë nevojë".

Kurti takon Abbottin: Sundimi i ligjit duhet të jetë parimi bazë për të ecur përpara

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Kryeministri Albin Kurti, pas telefonatës me sekretarin e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, James Cleverly, ka takuar ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott. Së bashku kanë diskutuar për zhvillimet aktuale, me theks për situatën e fundit në veri të vendit, rëndësinë për

deeskalim të plotë dhe rrugën përpara. Në lidhje me këtë, kryeministri Kurti ka theksuar se sundimi i ligjit duhet të jetë parimi bazë për të ecur përpara. Sipas njoftimit të qeverisë, Kurti citohet të ketë thënë se vendosja e plotë e sundimit të ligjit në katër komunat në veri të Kosovës është e domosdoshme si për largimin e elementeve

kriminale, po ashtu edhe për një fushatë të hapur dhe fer para zgjedhjeve të lira e demokratike në të ardhmen. Kryeministri Kurti e ka falënderuar ambasadorin Abbott për angazhimin dhe bashkëpunimin e tij të vazhdueshëm në thellim dhe fuqizim të marrëdhënies dypalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar.



Sa draft-statute janë hartuar për Asociacionin?

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Për jetësimin e Marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, të cilën Prishtina dhe Beogradi e arritën dhjetë vjet më parë, aktualisht ekzistojnë katër draft-statute dhe draft-vizione.

Bashkësia ndërkombëtare insiston që Kosova ta themelojë Asociacionin i cili do të mbledhte rreth vetes komunat në Kosovë të banuara me shumicë serbe dhe themelimi i tij, nga faktori ndërkombëtar, është parë si "kusht mbi kushtet" në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e raporteve që ndërmjetësohet nga blloku evropian.

Qeveria e Kosovës deri më tani ka refuzuar ta themelojë Asociacionin, me arsyetimin se kompetencat e gjera të Asociacionit do ta kërcënonin funksionalitetin e brendshëm të shtetit. Megjithatë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka paraqitur një draft-vizion për "vetëmenaxhimin e komunitetit serb".

Themelimi i Asociacionit është kërkesë e vazhdueshme e Serbisë, por edhe e Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë, që ka mbështetjen e Beogradit zyrtar.

Draft-statuti i ekipit menaxhues

Më 2 maj, në raundin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, Ekipi Menaxhues, i përbërë nga katër përfaqësues serbë - paraqiti draft-statutin për themelimin e Asociacionit, që menjëherë u refuzua nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i cili tha se dokumenti nuk është në përputhje me kushtetutshmërinë e Kosovës.

Ky dokument, në të cilin ka pasur qasje "Radio Evropa e Lirë", ka 67 nene dhe nëntë kapituj.

Asociacioni, sipas këtij draft-statuti, do të jetë një "formë e veçantë organizimi, e themeluar me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe të pakicave" të të gjithë banorëve dhe komuniteteve që jetojnë në komunat që janë pjesë e Asociacionit. Ekipi menaxhues ka paraparë që qendra administrative e Asociacionit të jetë në Mitrovicë të Veriut dhe çdo komunë jothemeluese e tij mund të anëtarësohet në Asociacion, nëse Kuvendi i këtij organi e miraton një gjë të tillë.

Sa i përket strukturës organizative, Asociacioni parashihet të ketë Kuvend që zgjidhet nga komunat anëtare - që është organi suprem i Asociacionit. Në të çdo komunë do të kishte nga pesë përfaqësues. Po sipas këtij drafti, Asociacioni parashihet të ketë bord prej shtatë anëtarësh, dhe ky bord është organ ekzekutiv, i zgjedhur nga Kuvendi, institucion të cilit i raporton.

Kuvendi, po ashtu, zgjedh kryetarin e Asociacionit, ndërkaq është



paraparë të ketë edhe Këshill të Asociacionit si organ këshillues.

Gjithashtu, është paraparë që Asociacioni ta ketë administratën e vet e cila i raporton Bordit.

Draft-statusi i hartuar nga Ekipi Menaxhues parashihet që Asociacioni t'i ketë simbolet, himnin, flamurin dhe stemën e vet. Sa iu përket kompetencave, në këtë dokument thuhet se Asociacioni mund të miratojë vendime dhe rregullore të Kuvendit, ta mbikëqyrë zbatimin e ligjeve, t'i rregullojë zgjedhjet, ta riorganizojë dhe ta bëjë funksionimin e organeve, të agjencive, ndërmarrjeve publike, si dhe ta bëjë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore. Asociacioni, po ashtu, mund ta propozojë mbajtjen e referendumeve dhe t'i shpallë ato me kërkesën e 10 për qind të votuesve që banojnë në komunat që janë pjesë e këtij organi.

Gjithashtu, ai mund të vendosë për të marrë hua, ta miratojë buxhetin vjetor, të themelojë agjenci, organizata, ndërmarrje dhe institucione publike financiare dhe fonde dhe ta mbikëqyrë punën e tyre.

Në kuadër të kompetencave është paraparë që Asociacioni të mund t'i regjistrojë votuesit, të mbajë të dhëna për regjistrat e lindjeve, martesave dhe vdekjeve.

Sipas dokumentit të siguruar nga REL-i, Asociacioni parashihet ta emërojë komandantin rajonal policor për katër komunat në veri [Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok].

Ekipi Menaxhues ka paraparë në draft-statut që Asociacioni të ketë status të entitetit juridik, që nënkupton se ka të drejtë të padisë dhe të paditet dhe të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

Në draft-statut është paraparë edhe raportit që do të ketë

Asociacioni me autoritetet qendrore. Marrëdhëniet do të jenë "të bazuara në parimet e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe shkëmbimit të informacionit", "duke promovuar interesat e komunitetit serb". Asociacioni parashihet të ketë drejtë të propozojë ndryshime në ligje si dhe të propozojë përfaqësues në organet dhe institucionet e organeve qendrore.

Ky organ, gjithashtu, duhet ta ketë buxhetin e vet dhe mund të gjenerojë të ardhura bazuar në pjesëmarrjen e komunave anëtare, nga shërbimet e ofruara, taksat dhe nga fondet e ndara nga buxheti i Serbisë.

Drafti parashihet që burimet natyrore që gjenden në territorin e komunave anëtare të Asociacionit, të menaxhohen nga Asociacioni, ashtu si edhe asetet me interes, si: tokat bujqësore, pyjet dhe ujërat tokësore. Por, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, deklaroi më 2 maj se anëtarët e Ekipit Menaxhues, që e kanë shkruar këtë statut, "qartazi" kanë dëshirë të krijojnë "një Republikë Sërpska" në Kosovë - referencë për entitetin me shumicë serbe në Bosnjë-Hercegovinë që ka kompetenca që sfidojnë pushtetin qendror.

Draft-vizioni i Kurtit

Pas refuzimit që i bëri draft-statutit të Ekipit Menaxhues - ekip të cilin më pas tha se e shkarkoi kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në Bruksel më 2 maj paraqiti atë që e quajti draft-vizion për çështjen e rregullimit të komuniteteve joshumicë, përkatësisht të komunitetit serb në Kosovë.

Në draft-vizionin e Kurtit nuk përmendet specifikisht Asociacioni, por ai thirret në nenin 7 të Marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Palët më 27 shkurt në Bruksel arritën këtë marrëveshje, kurse më 18 mars në Ohër u pajtuan për Aneksin e zbatimit të saj.

Ky nen i marrëveshjes kërkon që palët të sigurojnë "një nivel të përshtatshëm të vetëmenaxhimit të komunitetit serb në Kosovë".

Vetëmenaxhimi, sipas BE-së që ndërmjetëson dialogun, është referencë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Në këtë marrëveshje, po në nenin 10 thuhet, se palët duhet t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog, përfshirë edhe atë për krijimin e Asociacionit.

Kurti ka thënë se një draft-statut për Asociacionin duhet t'i plotësojë disa kushte. Ai në këtë kuadër ka theksuar se një organ i tillë duhet "t'ua ofrojë pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë mundësinë për t'i promovuar dhe mbrojtur interesat e veta përmes një kornize vetëmenaxhimi".

Në draft-vizionin e paraqitur nga kryeministri i Kosovës parashihet, sikurse edhe në dokumentin e Ekipit Menaxhues, mundësia e bashkëpunimit me institucionet e Kosovës si dhe të "njihen plotësisht karakteristikat kushtetuese" të Kosovës, duke respektuar pavarësinë dhe integritetin e saj territorial.

Kurti në draft-vizionin e tij ka parë që komuniteti serb të ketë kanal të drejtpërdrejtë komunikimi me ekzekutivin në Prishtinë dhe të ketë mundësi që të financohet nga Kosova dhe shtetet e tjera, përfshirë edhe Serbinë. Megjithatë, të gjitha financimet, sipas dokumentit të Kurtit, duhet të kalojnë përmes procedurave dhe rregullave të Ministrisë së Financave të Kosovës. Në draft-vizion thuhet se do të mund të themelohen asociacione në fushën e kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe asociacione të natyrave të ndryshme për "shprehjen, ushqyerjen dhe

zhvillimin e identitetit serb", bazuar në ligjet aktuale për ushtrimin e shërbimeve jofitimprurëse.

Kurti ka deklaruar se është i gatshëm ta thellojë këtë draft-vizion, por ai ka thënë se palët duhet të pajtohen për parimet e Asociacionit.

Kurti insiston që një asociacion të mos e cenojë funksionalitetin e Kosovës dhe të jetë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2015, e cila gjeti që Marrëveshja mbi parimet për themelimin e Asociacionit - që Prishtina dhe Beogradi e arritën më 2015 - nuk ishte plotësisht në harmoni me aktin më të lartë juridik të shtetit, por që këto mospërputhje, sipas Kushtetueses, mund të harmonizohen me akte ligjore.

Draft-statuti i Ramës

Më 8 qershor kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e njoftoi opinionin se një ditë më herët i kishte dërguar presidentit të Francës, Emmanuel Macron, dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz, një draft-statut për Asociacionin.

Rama tha se për këtë dokument e ka vënë "në dijeni edhe palën amerikane".

Kryeministri i Shqipërisë tha se dokumenti është konfidencial.

Megjithatë, ai tha se është i bindur se ky draft-statut është "një dokument i nivelit më të lartë ndërkombëtar që merr në konsideratë të gjitha arsyet për krijimin e Asociacionit dhe që Asociacioni është pjesë e organizimit të jetës për Kosovën".

Ky draft-statut, sipas Ramës, është hartuar nga ekspertë të pavarur dhe se ai vetë ka dhënë kontribut në të. Megjithatë, kryeministri shqiptar e pranoi se për këtë dokument nuk është konsultuar me homologun e tij kosovar. Rama, po ashtu, tha se është i

shqetësuar për situatën në të cilën ndodhet Kosova dhe ai nuk dëshiron që situata të përkeqësohet edhe më tej apo të vendosen sanksione ndaj Prishtinës. "Për mua është i pakuptimtë pozicioni i Kosovës, se Serbia bën atë që ka bërë herë të tjera. Palët nuk po merren vesh kush duhet ta shkruajë këtë tekst e jo më se si duhet hartuar", shtoi Rama.


Draft-statuti për Asociacionin i hartuar nga FES

Në fund të janarit të këtij viti organizata gjermane Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) publikoi një draft-statut për themelimin e Asociacionit në përputhje me Kushtetutën dhe sistemin juridik të Kosovës ashtu siç insiston edhe qeveria e kryeministrit Kurti. I përbërë nga shtatë kapituj dhe 18 nene, ky draft-statut i hartuar nga FES-i parasheh mënyrën e themelimit, strukturën organizative, marrëdhëniet me autoritetet qendrore, rregullimin ligjor, buxhetin, si dhe aspekte të tjera të funksionimit të Asociacionit, përfshirë simbolet. Sipas FES, Asociacioni mund të ushtrorë edhe kompetenca shtesë të cilat mund të delegohen nga autoritetet qendrore të Kosovës. Sa i përket strukturës, ky draft-statut ka paraparë që Asociacioni të ketë: Kuvendin, kryetarin, nënkryetarin, Këshillin dhe Bordin e Asociacionit. FES ka paraparë disa objektiva të këtij organi, sikurse forcimi i demokracisë lokale, duke lehtësuar, financuar ose promovuar aktivitetet që avancojnë pjesëmarrjen qytetare dhe praktikën demokratike, si dhe përfaqësimin e interesave të rëndësishme për demokracinë lokale. Sikurse edhe draft-statuti i hartuar nga Ekipi Menaxhues, edhe dokumenti i FES-it parasheh që Asociacioni ta ketë statusin e

subjektit juridik, të cilin thuhet se duhet t'ia japë Qeveria e Kosovës përmes një akti juridik. Sipas dokumentit në organizatën gjermane, Asociacioni do të financohet nga kontributet e anëtarëve të tij, të ardhurat nga shërbimet e ofruara nga Asociacioni, pasuritë e tij të luajtshme ose të paluajtshme, transferet nga autoritetet qendrore, grantet, donacionet, si dhe nga mbështetja financiare e shoqatave dhe organizatave të tjera, vendase dhe ndërkombëtare, duke përfshirë Republikën e Serbisë. Ndërkaq sa i përket buxhetit, në këtë draft-statut është paraparë që Asociacioni të financohet nga kontributet e komunave pjesëmarrëse, nga të ardhurat e shërbimeve që ofron ky organ, pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme, transferet nga autoritetet qendrore, grantet, donacionet, si dhe nga mbështetja financiare e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë Serbinë. Gjatë rishikimit të buxhetit, sipas dokumentit, Qeveria e Kosovës dhe Auditori i Përgjithshëm mund të kenë qasje. Auditori, po ashtu, është paraparë t'i bëjë kontrollat për shpenzimet e këtij organi. Sipas draft-statutit të FES-it, Asociacioni do të përjashtohet nga detyrimet dhe taksat në arrijen e objektivave të tij, në të njëjtën mënyrë sikurse komunat pjesëmarrëse. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara vazhdimisht kërkojnë nga qeveria e kryeministrit Kurti ta themelojë Asociacionin. Blloku evropian ka thënë se i ka ofruar Kosovës disa modele ekzistuese evropiane për të drejtat e pakicave kombëtare. Ndërkaq, ShBA-ja ka përsëritur disa herë se nuk përkrah një asociacion që do të krijonte "shtet brenda shtetit". Së fundi, Qeveria e Kosovës ka thënë se për të krijuar një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb, do të shtyjë përpara një model kroat për pakicat kombëtare.



Mavraj: Në plan kushtetues, Shqipëria e ka për detyrë të interesohet për të drejtat kombëtare kudo



Publicisti Muhamet Mavraj ka shkruar pas reagimeve që po bëhen këtu në Kosovë kundër iniciativës së kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, i cili u ka dërguar një draft për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, presidentit të Francës, Emmanuel Macron, dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz. Mavraj ka shkruar në "Facebook" se në plan kushtetues, Shqipëria e ka për detyrë të interesohet për të drejtat kombëtare kudo, edhe në Kosovë. "Askush në Kosovë as në trojet e tjera shqiptare nuk ka të drejtë t'ia përplasë derën Shqipërisë", ka shkruar ai. Mavraj ka shkruar se në planin moral, planin human, në rrafshin kulturor jemi i njëjti trup. "Në planin politik e të luftës, është e para në të gjitha kohët. Shpallim pavarësi e referendum herët më 1990, por Shqipëria dhe ShBA-në ishin të parat tërësisht në krah", ka shkruar Mavraj.

Postimi i Mavrajt:

Askush në Kosovë as në trojet e tjera shqiptare nuk ka të drejtë t'ia përplasë derën Shqipërisë. Ne të gjithë jemi Shqipni, të ndarë me zor. Kemi endrren tonë pavarësisht trushpërlarëve ideologjikë të vjetër një shekull. Në plan kushtetues, Shqipëria e

ka për detyrë të interesohet për të drejtat kombëtare kudo, pra detyrë; Në planin moral, planin human, në rrafshin kulturor jemi i njëjti trup. Në planin politik e të luftës, është e para në të gjitha kohët. Shpallim pavarësi e referendum herët më 1990, por Shqipëria dhe ShBA-ja ishin të parat tërësisht në krah; I tërë territori i Shqipërisë ishte strehë e territor i luftëtarëve tanë, i ushtrisë së NATO-s gjatë luftës e tutje, i të dëbuarve me forcë gjatë luftës në Kosovë. Është Piemonti ynë dhe me shumë se kaq. Zoti të ruajtë Shqipni e njëfsha mirë për Ty!



Hill: Kemi probleme shumë thelbësore me Kurtin



PRISHTINË, 9 QERSHOR - Ambasadori amerikan në Beograd, Christopher Hill, ka theksuar se Uashingtoni ka "disa probleme shumë thelbësore" me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Në një intervistë për "Zërin e Amerikës", Hill u pyet nëse Kurti është i gatshëm t'i pranojë tri kërkesat e komunitetit ndërkombëtar për uljen e tensioneve në veri të Kosovës.

"Mendoj se kemi një problem me z. Kurti, ai nuk është i gatshëm ta pranojë. Më duket se kemi disa probleme shumë thelbësore me të, nëse ende mund ta konsiderojmë si partner. Por, këtë vendim ia lë ambasadës sonë në Prishtinë", ka thënë ai. Javën që shkoi i dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe ai i Bashkimit Evropian për

dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, qëndruan në Prishtinë dhe Beograd për t'i ndihmuar palët që t'i ulin tensionet. Dy zyrtarët paraqitën tri kërkesa për Qeverinë e Kosovës: qetësimin e situatës në veri të Kosovës, mbajtjen e zgjedhjeve të reja lokale në katër komunat veriore dhe rikthimin në dialogun për normalizimin e raporteve Kosovë - Serbi.



Ndërtohen muret mbrojtëse në Skorobisht të Prizrenit

PRIZREN, 9 QERSHOR - Ka përfunduar ndërtimi i mureve mbrojtëse në fshatin Skorobisht të komunës së Prizrenit, duke ngritur kështu nivelin e sigurisë së banorëve nga rreziku potencial i

rrëshqitjes së dheut. Me këtë rast, është bërë edhe zgjerimi i rrugëve që krijon siguri më të madhe për pjesëmarrësit në komunikacion. "Janë ndërtuar katër mure mbrojtëse me gjatësi 294 metra dhe është realizuar

kanalizimi atmosferik me gjatësi 105 metra. Mbetemi të përkushtuar për realizimin e infrastrukturës funksionale dhe të sigurt për qytetarët", ka thënë kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj.

Sot në shtëpinë e atdhetarit të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli, do të vendoset pllakë përkujtimore

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Shoqëria Lëvizja ka njoftuar se sot (më 10 qershor) në orën 13:00 në shtëpinë e atdhetarit dhe veprimtarit të dalluar të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli, në Kodrën e Trimave në Prishtinë, do të vendoset pllakë përkujtimore për nder të këtij veprimtari dhe luftëtari të lirisë, shtëpia e të cilit ishte bazë e sigurt e Lëvizjes Kombëtare dhe e luftës çlirimtare. Para vendosjes së pllakës përkujtimore do të bëhen homazhe te varri tij në varrezat e qytetit në orën 12:30.

Njoftim - ftesë

Veteranë të nderuar të Lëvizjes Kombëtare!
Veteranë të Luftës Çlirimtare!
Të nderuara familje të Dëshmorëve të Atdheut!
Bashkëkombës e bashkëqytetarë

shqiptarë!

Në 125-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe në 24-vjetorin e nënshkrimit të kapitullimit të Serbisë, më 10 qershor, Shoqëria Lëvizja vendos pllakë përkujtimore në shtëpinë e atdhetarit dhe veprimtarit të dalluar të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli.

Manifestimi për nder të këtij veprimtari dhe luftëtari të lirisë, shtëpia e të cilit ishte bazë e sigurt e Lëvizjes Kombëtare dhe e Luftës Çlirimtare, do të fillojë me vendosjen e luleve te varri i tij në varrezat e qytetit, të shtunën, më 10 qershor 2023, në orën 12:30.

Pas homazheve bëhet zbulimi i Pllakës në orën 13:00 te shtëpia e familjes Makolli (Kodra e Trimave, Prishtinë).

Me respekt!
Shoqëria Lëvizja



Në momentet më kritike të ballafaqimit të popullit shqiptar me dhunën policore dhe ushtarake serbe, shtëpia e veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Shasivar Makolli, u shndërrua në një bazë të fuqishme të rezistencës sonë kombëtare, prej ku ka filluar një numër i konsiderueshëm i aksioneve kundër okupatorëve serbë.

Në familjen e Shasivar dhe Sevdije Makollit, ku të gjithë anëtarët ishin të lidhur me kauzën kombëtare, gjetën strehim, ngrohtësi dhe mikpritje karakteristike shqiptare figura të shquara të historisë sonë moderne, duke filluar nga simboli i rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, e deri te drejtues të rëndësishëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Presheves, Medvegjes dhe Bujanocit.

Prishtinë, 10 qershor 2023



Fillojnë aktivitetet për Ditën e Çlirimit të Malishevës dhe për Ditën e Dëshmorëve

MALISHEVË, 9 QERSHOR - Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Malishevë, Fitim Shala, i ka njoftuar anëtarët e komitetit për arsim për aktivitetet që kanë filluar të premten e që do të vazhdojnë deri më 16 qershor për Ditën e Çlirimit të komunës së Malishevës dhe Ditën e Dëshmorëve.

Aktivitetet kanë filluar me shpalljen e rezultateve të konkursit letrar dhe do të vazhdojnë për shtatë ditë me aktivitete sportive, përfundim veprash, dhurim gjaku dhe me manifestimin qendror "Marshojmë së bashku për nderim të dëshmorëve", me pjesëmarrje të institucioneve komunale, arsimore, shëndetësore si dhe të shoqatave e klubeve të cilat zhvillojnë



veprimtaritë në komunën e Malishevës. Anëtarët e komitetit vazhduan

vizitat në shkollën "Hasan Prishtina" në Tërpezë dhe "Rifat Berisha" në Berishë.

350 parkingje të reja në Drenas

DRENAS, 9 QERSHOR - Komuna e Drenasit ka njoftuar edhe për 350 parkingje të reja në një hapësirë (parking publik) ndër më të mëdhenjtë në Kosovë, tërësisht në shfrytëzim të qytetarëve të Drenasit. "Këto hapësira të reja, së bashku me

projektin madhor të sheshit, do t'i japin Drenasit pamje të cilën do ta ketë lakmi çdokush...", ka njoftuar komuna e Drenasit, duke theksuar se do ta vazhdojë karvanin e investimeve infrastrukturore për të mirën e qytetarëve.



Një qytetar në Pejë e gjen një kuletë me 600 euro dhe e dorëzon në polici

PEJË, 9 QERSHOR - Më 8 qershor, rreth orës 19:30, në Stacionin Policor në Pejë, një qytetar ka deklaruar se i kishte humbur kuletë me dokumente personale dhe para në shumën prej 600 eurosh. Derisa ishte duke raportuar rastin në Stacionin Policor në

Pejë, është paraqitur qytetari i cili e kishte gjetur kuletën në rrugë dhe të njëjtën e ka sjellë në polici. Kuletë së bashku me dokumentet dhe paratë që i kishte në kuletë i janë kthyer qytetarit.

Policia e Kosovës e ka

falënderuar qytetarin për veprimin e bërë dhe nivelin e lartë të përgjegjësisë qytetare. "Apelojmë te qytetarët, që shembuj të tillë të bashkëpunimit me Policinë e Kosovës të vazhdojnë edhe në të ardhmen", thuhet në njoftimin e policisë.



Organizatave të shoqërisë civile e kundërshtojnë Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme

Shtatë organizata të shoqërisë civile e kanë kundërshtuar miratimin nga ana e Kuvendit të Kosovës për Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Sipas tyre, ky projektligj nuk adreson nevojën për reformë zgjedhore dhe është miratuar pa kosto financiare. Këto organizata të shoqërisë civile thonë se ky projektligj reflekton më shumë një kompromis midis partive politike të cilat i kanë shtyrë përpara interesat e tyre në raport me integritetin e kandidatëve, votimin preferencial, votimin jashtë vendit dhe pavarësinë e KQZ-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës e ka miratuar të enjten Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në të dy leximet brenda të njëjtës seancë. Sipas shtatë organizatave të shoqërisë civile, Demokracia për Zhvillim (D4D), Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Lëvizja FOL dhe Organizata Çohu, ky projektligj nuk adreson nevojën për reformë zgjedhore dhe është miratuar pa kosto financiare. "Praktikat e miratimit të projektligjeve të rëndësishme në procedura të përshpejtuara janë në kundërshtim dhe të dëmshme për standardet e jetës parlamentare. Ky projektligj nuk adreson nevojën për reformë zgjedhore që u proklamua si e tillë edhe në emrin e komisionit ad-hoc. Për më tepër, përmbajtja e këtij projektligji, përveç pjesës 'kozmetike', nuk adreson shumë prej mangësive përmbajtësore

të sistemit zgjedhor, e në disa raste veçse i përkeqëson ato", është thënë në reagimin e këtyre organizatave të shoqërisë civile. Më tej në reagim theksohet se në esencë ky projektligj reflekton më shumë një kompromis midis partive politike të cilat i kanë shtyrë përpara interesat e tyre në raport me integritetin e kandidatëve, votimin preferencial, votimin jashtë vendit dhe pavarësinë e KQZ-së. "Këto çështje nuk janë adresuar as gjatë punës së komisionit ad-hoc, por as në kuadër të angazhimit tonë para votimit të projektligjit në seancë. Për më shumë, as propozimet dhe amendamentet konkrete që kemi propozuar lidhur me çështjen e integritetit të kandidatëve dhe pavarësisë së KQZ-së nuk janë marrë parasysh nga Komisioni Parlamentar për Legjislacion", është theksuar në reagim.

Organizatave të shoqërisë civile kanë theksuar se ndonëse me efektet të cilat do t'i cenojnë vlerat dhe standardet dhe integritetin zgjedhor, me këto pasoja të këtij projektligji do të



ballafaqohemi qysh në procesin e ardhshëm zgjedhor. "Lista e kandidatëve dhe të zgjedhurit që mund të jenë pjesë e Kuvendit të Kosovës, kuvendeve komunale apo kryetarë të komunave, potencialisht do të jenë individë të dënuar për vepra penale me më pak se një vit burgim, me kusht apo me gjobë - e që përbëjnë rreth 80 % të rasteve vetëm vitet e fundit. Në anën tjetër, pozita e kryesuesit dhe e anëtarëve të KQZ-së do të politizohet dhe do dëmtohet kredibiliteti dhe imazhi i këtij institucioni të pavarur për shkak se shkarkimi i tyre për shkelje të integritetit do të mund të bëhet vetëm me miratim të 2/3 të anëtarëve.

Ne shprehim kundërshtimin tonë dhe vazhdojmë ta alarmojmë publikun dhe të gjithë aktorët se reforma zgjedhore, e nisur para më shumë se një dekadë, u shfrytëzua nga partitë politike për akomodim të

interesave partiake në dëm të integritetit zgjedhor e jo me qëllim burimor të përmirësimit të sistemit zgjedhor dhe nivelit të përfaqësimit politik në Kosovë", thuhet në këtë reagim.

Koalicioni i OJQ-ve, të cilat janë të angazhuara për rritjen e

integritet zgjedhor, duke vlerësuar këtë ligj të një rëndësie të veçantë për nivelin e demokracisë në Kosovë, do t'i ndjekë edhe format tjera për kundërshtimin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i cili do ta cenojë integritetin zgjedhor.

Shqiptarja bëhet heroinë në Zvicër, i shpëton jetën një katërvjeçar që po mbytej në pishinë

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Një 34-vjeçare nga Kosova që jeton në Aargau, Zvicër, është bërë heroinë pasi ka shpëtuar jetën e një djali katërvjeçar që po mbytej në pishinë.

Nazlie Selimaj, e cila punon infermiere, ka ndërhyrë menjëherë pasi e pa djalin duke u mbytur në një pishinë në kantonin St. Gallen. Ajo kishte shkuar në pishinë për të kaluar një ditë të bukur me familje, por u bë dhe shkak për shpëtimin e jetës së djalit afgan. "Po haja akullore me burrin dhe djemtë e mi 5 dhe 9 vjeç, kur burri pa një baba që po vraponte te pishina. Ai e nxori djalin nga uji dhe po e mbante në krah pa ndjenja. Babai i tij ishte i shkatërruar", u



shpreh 34-vjeçarja për median "Blick".

Ajo vrapoi menjëherë tek ata të dy, e mori fëmijën nga krahët e të atit dhe i dha ndihmën e

parë. "E shtriva djalin në dysheme sepse nuk i ndjeva pulsën dhe i masazhova zemrën me një rën dorë. Atij i erdhi vetëdija", u shpreh Nazlia.



Koloneli i FSK-së, Ismajl Brahimi, diplomoi në Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare të ShBA-së

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Koloneli Ismajl Brahimi diplomoi me sukses në Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kolegji Kombëtar i Luftës në Fort McNair Washington D.C.

Të pranishëm në ceremoni ishin kryetari i Shefave të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral Mark A. Milley nga Forcat Ajrore të ShBA-së, gjeneralletjnant Michael T. Plehn si dhe komandanti i Kolegjit Kombëtar të Luftës, gjeneral

brigade Jeffrey H. Hurlbert. Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me partnerët strategjikë, po vazhdon investimin në avancimin profesional të ushtarakëve të FSK-së, si njërin ndër objektivat më të rëndësishme të ministrisë për përmbushjen e qëllimit për zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në përputhje me standardet e NATO-s, për të qenë kontribuues në ruajtjen e paqes në vend, rajon dhe më gjerë.

Bie kostoja e ndërtimit në Kosovë

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Kostos së Ndërtimit për tremujorin e parë të vitit 2023.

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë thuhet se ka pasur rënie për (-1.3 %) në tremujorin e parë të vitit 2023 krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2022. Rënie më të

madhe kishin: transporti (-6.9 %); materialet (-1.4 %); dhe pagat (-0.4 %), ndërsa rritje kishte te: kostot e tjera (1.4 %); makineritë (0.9 %); dhe energjia (0.5 %).

Ndërkaq, krahasuar tremujori i parë i vitit 2023 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, Indeksi i Kostos së Ndërtimit kishte rritje për 3.3 %.

Indeksi i tërësishëm i Kostos së Ndërtimit në Kosovë pati rritje për 3.3 % në TM1 2023 krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2022.

Rritja kryesisht u vërejt te: transporti (16.4 %); makineritë (11.1 %); kostot e tjera (10.1 %); pagat (2.8 %); dhe materialet (2.4 %), ndërsa kishte rënie tek energjia me (-14.9 %).



A u rritën sërish normat e interesit të kredive?

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Banka Qendrore e Kosovës ka mohuar se ka sërish rritje të normës së interesit në kredi gjatë këtyre ditëve. Norma e interesit në muajit mars dhe prill është e njëjta 6.30 %, ka bërë me dije për "Telegrafi"-n, zëdhënësi i Bankës Qendrore të Kosovës, Kushtrim Ahmeti. "Ju njoftoj se norma e interesit në kredi në dy muajt e fundit mars dhe prill është e njëjta 6.30 %", ka thënë ai. Normat e interesit në kredi kanë nisur të rriten në shumë vende në botë gjatë muajve të kaluar. Kjo ka ndodhur si rezultat i shtrëngimit të politikave monetare nga bankat qendrore për shkak të shkallës së lartë të inflacionit. Në Kosovë veprojnë aktualisht 12 banka komerciale dhe vlera e

kredive në to ka arritur në mbi 4 miliardë euro. Gjithashtu, Kosova mbetet i vetmi treg i jashtëm ku sektori bankar shqiptar ka arritur të vendosë një prani të qëndrueshme.

Të dhënat nga Shoqata e Bankave të Kosovës tregojnë se pjesa e tregut të dy bankave me kapital mbizotërues shqiptar ka vazhduar të rritet në vitin e fundit. Në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, bankat komerciale në Kosovë i përcaktojnë individualisht normat e interesit bazuar në politikat e tyre afariste dhe BQK-ja nuk mund të ndërhyjë të to.

Banka Qendrore e Kosovës kishte paralajmëruar se do të ketë rënie të normës së rënive të interesit në kredi, por që deri tani nuk ka pasur asnjë rënie.



Ndalohehen pesë persona të dyshuar kontrabandim të mallrave dhe artikujve të dëmshëm ushqimorë



PRISHTINË, 9 QERSHOR - Policia e Kosovës i ka ndaluar të premtën pesë persona të dyshuar për kryerje të veprave penale, "kontrabandim i mallrave", "prodhim dhe vënie në qarkullim të artikujve të dëmshëm ushqimorë" dhe "mashtim të blerësve".

Me vendim të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, të dyshuarit me inicialet K. Gj., E. Gj., Q. Sh., M. Sh. dhe E. I. janë ndaluar për 48 orë.

Policia ka thënë se ata janë ndaluar pas një operacioni të gjerë, të zhvilluar në Prishtinë, Ferizaj dhe Prevallë, i cili është realizuar në bashkëpunim me Doganën e Kosovës, Inspektorë të Tregut dhe Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUVK). Sipas Prokurorisë, ata

dyshohen se prej marsit të vitit 2023 kanë bartur mallra, duke e shmangur kontrollin doganor përmes pikës kufitare që lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut.

Sipas komunikatës, duke shfrytëzuar rrugët malore, këta persona kanë "kontrabanduar mallra të emëruara si 'mjaltë' me origjinë nga vende të ndryshme, e cila futet në paketime të ndryshme dhe në kavanoz dhe këto mallra futen në Kosovë duke iu shmangur kontrollit doganor".

Në të është thënë, po ashtu, se që prej marsit këto mallra të kontrabanduara janë vënë në qarkullim me shënjim që nuk përkon me përmbajtjen dhe prejardhjen apo kualitetin e produktit.

Takimi Biden - Sunak, në fokus thellimi i bashkëpunimit ekonomik

UASHINGTON, 9 QERSHOR - Presidenti Joe Biden ka zhvilluar një takim me kryeministrin e Britanisë së Madhe, Rishi Sunak, i cili ndodhet për një vizitë në

Shtetet e Bashkuara. Ndër çështjet kryesore që diskutuan dy udhëheqësit janë thellimi i bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve si dhe agresioni rus ndaj Ukrainës.

Ky është takimi i tyre i katërt në disa muaj dhe vjen në një kohë kur vendet perëndimore po përpiqen të përcaktojnë nëse përgjegjëse për shkatërrimin e digës Nova

Kakhovka në rajonin e Khersonit në Ukrainë është Rusia. Të dy udhëheqësit koordinuan përpjekjet për ta forcur sigurinë ekonomike të dy vendeve.



Në vend të reportazhit për festivalin "I këndojmë lirisë"

Nga Kulla e Gurtë, në Qytetin e Festivalit



Bedri GASHI

Që në mëngjes u hapën portat e drunjtat në kullën e gurtë të bacës Lilë. Para nesh shfaqet flamuri kombëtar, oborri i gjerë, statujat e mermerta të tre dëshmorëve dhe tendat për mysafirë. Të gjitha duken hijerënda dhe krenare. Kujtimet vijnë e bëhen tok me mesin e ditës, duke lartësuar ndriçimin e tyre që depërtojnë ngadalë zgavrave të ngushta të kohës dhe mori dhenë me dritën e shenjtë të saj që çliron veten dhe tokën tonë.

Në vigjilje të fillimit të këtij edicioni në Klinë, në Qytetin e Festivalit, pak para mbrëmjes, qytetarët ecin nxitimthi, shkojnë drejt sheshit të madh, këtij sheshi të hijshëm dhe të mbushur përplot pemë, të mbjella me aq shije përgjatë rrugës kryesore. Defilojnë ansamblet, trupat artistike, organizatorët dhe përcjellësit nga mbarë trojet shqiptare. Shkojnë rrugës së kalldrëmtë që i bie mospemes kësaj vatre të kulturës, të arsimit, të artit dhe të kontributit madhor për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Qyteti i Festivalit është vend i urtisë dhe i bashkëjetesës së pasur shpirtërore. Në këtë qytet, sheshi qendror i tij është qendrëstar i madh i kohës. Lartëson kujtesën në ballin e kohës dhe në gjirin e tij ruan shtatoren e Mujë Krasniqit - Kapuçit.

Dikur fillon të duket mbrëmja verore e qershorit dhe në këtë fillimbrëmje që është nata e parë e Festivalit, duket sikur shumëzohet masa e qytetarëve. Pastaj shumëzohen edhe natën e dytë, të tretën... Në orën njëzet nis

jehona e madhe që shpërndahej gjithandej sheshit dhe rrethinës. Të gjithë bëhen sy e vesh. Të gjithë drejtojnë sytë kah skena imponante. Pallatet përreth më nuk mbesin pa drita si dikur. Te Ura e Haxhisë dikush mirëpret mysafirët në hyrje të qytetit. Athua ç'është të bëhet në ditën e katërt kur ky eveniment do të përmbillet! Ndoshta Drini do të joshë zogjtë për të kënduar brigjeve të tij, sepse zemra e Qytetit të Festivalit ruan për vete një shtjellë të madhe dhe lëshon shpirtin në eter; e shpërndanë si kolonë zanore të pashuar; e hedhë në hapësirë me miqësitë e reja që u zunë, me bisedat e panumërta që u bënë për performancën e këngëtarëve dhe valltarëve anembanë shqiptarisë. Klina do të pikturojë rrathët e rinj mbi mozaikë këngësh dhe kujtimesh kombëtare. Natyrisht nuk do të pajtohet të mbarojë gjithçka kaq shpejt. Një kor i padukshëm, si vetë rrjedha e lumenjve klinas do të ecën edhe shumë ditë më pas. Qyteti i Festivalit do të ndritë edhe muajve të tjerë, i parëthuar nga harresa, ndaj tekefundit, bukur gjatë, të gjithë i këndojmë lirisë.

Gjurmët e kohës në rrëfime

Duke qëndruar mes haresë së njerëzve, brenda Qytetit të Festivalit, dëgjon qytetarët tek flasin për heroin e tyre dhe gjurmët e tij në domenin e artit të qëndrës kombëtare për liri, pavarësi dhe, qoftë e thënë përjetshëm, edhe për gjurmët e ardhshme për bashkimin kombëtar. Ky festival, është shenjë identiteti, nga i cili burojnë pararendje të themelta të një protagonistit të shquar historik. Dëgjon tek thuhet mes tyre se kënga shqip mbajti gjallë frymën e qëndrës, formësoi breza e breza nën kultin e saj, nën tabanin dhe strehën epike të vatanit ku ndizej zjarri i madh e ku digjej trunqet që fliste shqip,



digjeshin degët që lëkundeshin shqip, ku fletët binin e ridilnin shqip. Qyteti i Festivalit hyn në krijimtarinë e pandalshme kolosale me Mujën që amshon në deltën historike. Dëgjon bashkëveprimtarët e tij, që, thonë se pikërisht në sallën ku këndoi Muja mbahen akademi për kujtimore për figurën e tij - në Jehonën e Dukagjinit apo në Sallën e Kuqe në Prishtinë. Thonë se Muja vazhdoi të këndojë, të këndojë e të këndojë pafund, në mënyrë të paepur, edhe pse dimrat e robërisë së Kosovës vazhdonin atëherë vallen e pashkëputur dhe zbardhnin malet e saj si statuja të bardha. Pastaj, flasin bashkëlufetarët e tij, që thonë se nuk vonoi shumë dhe një gjë iu bë lajtmotiv jete - lufta e pakompromis çlirimtare kundër aparatit policor dhe ushtarak të shtetit serb që sundonte Kosovën.

Ata, thonë që Ai nuk e harroi këngën edhe në çaste më vendimtare të betejave të shumta që zhvilloi. Në mendjet e tyre ka mbetur thellë, se Ai ishte himn, mobilizim, kushtim, apel, grishje e pambarimtë për daljen nga robëria serbe. Evokojnë kujtime për forcën e tij qëndrestare në kohën kur ende askush nuk ia zgjaste dorën popullit të tij për t'u ngritur nga balta e sundimit. Edhe vetë skena e Festivalit, rrëfen se kur u ngrit Ai për liri ishte çasti i artit historik dhe Ai nuk hyri vetëm për të marrë pjesë në vullkanin e luftës së armatosur të shqiptarëve të Kosovës që të shuhej për një kohë të shkurtër dhe që ëndrra e tij për liri të mbetej vetëm në kujtesën rapsodike. Në rendjet e reja të këtij festivali nuk vdes epika shqiptare, si një thirrje fundore për ndryshimin e kapitullit njerëzor të flijimit dhe kontributit atdhetar, që edhe me Aliun e Beqën u zgjua si një okarinë e lashtë dhe krejt papritmas u afrua pranë një harfe të braktisur dhe guximshëm lëviz nëpër ajër, duke krijuar harmoninë e rrallë të lirisë. Këngëtarët kujtojnë e rrëfejnë se gjatë kësaj kohe, një galaktikë tjetër e këngës shndriste anembanë vendit dhe më në fund i erdhi në ndihmë njësisë së Mujës me artin e melosit të trashëguar ndër breza. Beqir Sefë Gashi qëndroi pandashëm në krah të tij, si një bilbil i papërsëritshëm, me zërin e dhuruar nga vetë Perëndia. Ai ishte ylli i qiejve më të shndritshëm të këngës. Ishte ishull në vete dhe për vetë jetën. Ishte vetë nota e jetës dhe lartësia e skajshme e melosit popullor. Në

festival rrëfejnë edhe historianët me kumtesat e tyre, thonë, që, kur rrënjët e lirisë dhe flijimi i tillë atdhetar përputhen shëndetshëm është fat i madh për një komb. Kjo vlen për secilën grimcë të ajrit të Drenicës, Dukagjinit, Pashtrikut, Kosovës dhe Shqipërisë.

Kronistët dëgjojnë që rrëfejnë se nga ana e Llapushës veriore, ku shtrihet Çabiqi, ekziston një hambar i traditave të gërshetuara kulturore-historike dhe vesa e harresës nuk do të bie në asnjë mbrëmje mbi kullën e gurtë të Mujës dhe mbi Qytetin e Festivalit, sepse kufijtë e atdheut bashkohen këtu me fjalën, flijimin, lirinë, vallen, këngën, jetën...

Në Kullën e Gurtë dhe në Festivalin e Qytetit, këngët dhe rrëfimet shndërrohen në reportazh ligjërimesh për ushtarin e dalluar të atdheut Mujë Krasniqin - Kapuçin, kurse bukuria e lirisë shfaqet në secilin qershor dhe vështron matanë kohëve.

(Autori Bedri Gashi ishte bashkëlufetar i hershëm dhe krah i djathtë i Mujë Krasniqit - "Kapuçit", i plagosur më 25 mars 1998 në rrethinat e Kijevës, me ç'rast ishte shëruar në Abri të Naltë nga dr. Gani Halilaj, ku qëndroi deri më 11 prill 1998 dhe pas shërimit sërisht iu bashkua radhëve të tij)



FESTIVALI FOLKLORIK "I KËNDOJMË LIRISË"


Edicioni i 21-të
6, 7, 8 Qershor, KLINË

Studim gjithëpërfshirës për mitin dhe gjenocidin serb

Recension për librin e prof. dr. Arsim Bajrami, “Gjenocidi i Serbisë në Kosovë: aspekte juridike”, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2023

Prof. dr Agim ZOGAJ

Krimi serb mbi shqiptarët, në veçanti ndaj popullit të Kosovës, që nga mbretëria e Nemanjiçëve, përfshirë persekutorin e madh, Stefan Dushanin dhe deri në luftën e Kosovës në vitet 1998-1999 kishte qenë, gjenocid i organizuar dhe i paramenduar nga shteti serb dhe Kisha Ortodokse Serbe. Përbindëshit mesjetarë serbë, por edhe ata serbë të tjerë të epokave moderne, deri te, dje, tirani, nazisti patologjik, Millosheviç, sot bashkëkriminelët e tij, Vuçiqi, Daçiçi e tjerë, kurrë njëherë nuk u ndalën, në projektet, luftërat, për ta shfarosur racën e popullit shqiptar, me barbarinë më çnjerëzore që e njohin shek. XIX dhe shek. XX-të. Porositë fashioide serbe ishin shndërruar në opium gjithëserb: shqiptarët duhet zhdukur, ata janë fatkeqësia serbe, ata e pengojnë shtrijnë e panslavizmit në këto hapësira, në detin shqiptar, janë faktor destabilizues. Regjimet pushtuese serbe, logjika e tyre raciste, ne shqiptarëve na panë si komb, i cili, duhet zhdukur. Shqiptarët duhet përzënë nga Kosova, por, sipas ideologëve të nazifashizmit serb, ne shqiptarëve duhet përzënë edhe nga Shqipëria. Idetë e tilla, të shndërruara në ideologjinë gjenocidale serbe, në projektet çetnike shtetërore, janë shkruar, siç argumentohet në librin e prof. Arsim Bajrami, në elaboratet e Ilija Garashaninit, Jovan Cvejiçit, Vlladan Gjorgjeviçit, Vasa Çubrilloviçit, Ivo Andriçit, ideologut çetnik, Stevan Moljeviçit, ideologut të Shën-savizmit, peshkopit, Nikolaj Velimiroviç, më vonë, nga ideatorët e racizmit modern serb, Dobrica Qosiqit, Vojislav Shesheli dhe akademikëve të tjerë serbë të fundshekullit të XX-të. Kohë më parë, kryeministrja serbe, kishte thënë: “Ju keni punë me njerëz të cilët kanë dalë nga malet...”? Pra, e njëjta shqiptarofobi, e njëjta ideologji çetnike, raciste, sikur një shekull më parë kur, një ish kryeministër i atëhershëm serb, Vlladan Gjorgjeviç, në librin e botuar në gjermanisht shkruante (1913): “... shqiptarët flej në drunj, në të cilët, e kanë të lidhur bishtin!” Propaganda dhe dhuna serbe, në përmasa të gjenocidit kundër popullit shqiptar, siç argumenton, prof. Arsim Bajrami, duhet analizuar edhe në kontekstin e përplasjes së dy qytetërimeve: atij perëndimor, të cilit, historikisht i takojmë si komb, dhe qytetërimit lindor sllav/serb, që, ndryshe, përcaktojnë opsionet e demokracisë dhe të



totalitarizmit! Libri më i ri i profesor, Arsim Bajramit, është me tepër se një sprovë e guximshme akademike, sepse, për herë të parë, në fushën e mendimit akademik, politik shqiptar, argumenton të vërtetën, jo vetëm historike, juridike, se, Serbia në luftën e Kosovës, 1998 -1999, bëri gjenocid mbi popullin e Kosovës, se, Gjykata Speciale, dosjet e saja të montuara, janë një farsë, me objektiva politike të Serbisë dhe aleatëve të saj! Pasi i qartëson elementet kryesore të origjinës së gjenocidit, historinë e gjenocidit nëpër etapat historike, kriteret për penalizimin e gjenocidit, prof. Bajrami, duke iu referuar studiuesit, profesorit, ekspertit, Gregory Stanton, saktëson se, “... gjenocidi i Serbisë në Kosovë ka qenë një plan i orkestruar, planifikuar nga zyrtarë më të lartë në institucionet shtetërore, kulturore, edukative dhe fetare të shtetit serb me qëllim të shfarosjes së shqiptarëve dhe spastrimit etnik të territorit të Kosovës...”. Ngjashëm, sikur profesor Bajrami, edhe historiani amerikan, Robert J. Donia, nga Universiteti i Michiganit, shkruan se: “... nacionalizmi serb është ideologji e cila i ka ndryshuar rrjedhat historike, ka prodhuar spastrim etnik dhe së fundi gjenocid!”. Në fakt, siç e kishte thënë z. Kadri Veseli, në një mbledhje të Kuvendit të Kosovës, “Gjithçka në Kosovë ishte target i gjenocidit serb, vetëm pse ishim shqiptarë!” Miti i rrejshëm serb për Kosovën, ndërsa, ishte dhe vazhdon të jetë frymëzim ideologjik, trishtues për gjenocidin, për barbaritë serbe ndaj ne shqiptarëve. Miti i

rrejshëm serb për Kosovën, e bën ndërlidhjen midis politikës ekspansioniste serbe dhe mitologjisë nacionale, çetnike serbe për “Serbinë qiellore” dhe për, “Botën serbe”, përkatësisht, Botën ruse!” Të këtilla, ishin dhe janë elitat akademike, politike, shtetërore, klerike, të Serbisë, të cilat, edhe përmes ideologjisë së klerofashizmit serb, qe njëqind vjet, nuk u ngop dot, me gjakun e shqiptarëve! Në fakt, nga aspekti i së Drejtës Ndërkombëtare Penale, mbështetur në kriteret e Konventës së OKB-së, të vitit 1948, për krime dhe gjenocid, shteti i Serbisë, në mënyrë sistematike, në veçanti, gjatë viteve 1998-1999, i zbatoi metodat më brutale të gjenocidit mbi popullin e Kosovës. Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavi, në rastin e akuzimit të grupit drejtues të shtetit serb, kishte theksuar se dekretet përkatëse, të nxjerra nga shteti serb gjatë luftës në Kosovë, ishin në funksion të spastrimit etnik, deportimeve të dhunshme, zhdukjes së identitetit fizik të shqiptarëve dhe krimeve të tjera. Edhe Gjykata e Lartë në Beograd, njësia për krime lufte në rastin K-PO2, numër 48/ 10, në vitin 2000, kishte konfirmuar ekzistimin e planit gjenocidial i zbatuar në Kosovë. Në aktgjykimin përkatës, ndër të tjera, thuhet se ky grup kriminal: “... kanë privuar nga jeta civilët, duke shtënë mbi ta me pushkët e tyre dhe pasi e kanë kryer pushkatimin, i akuzuar Milojo Nikoliç, duke shkelur mbi trupat e kufomave dhe të plagosurve ka therur dhe ka vërtetuar kush nga të pushkatuarit po jep shenjë jete...!”

Sot, sërish, pyesim, në rast se, kriminelit serb, Nikoliç, apo cilido nga ata të tjerët sikur ai, i ka therur dhe, pastaj e ka vërtetuar nëse, asaj të shtune me kob, datë 17 prill 1999, ende ishin të gjallë edhe, Lirie Muçolli foshnjë, gjashtë muajsh dhe Qëndrim Muçolli tetë muajsh, kur në masakrën serbe në Poklek u masakruan, u dogjën 54 veta, ndër ta, 23 fëmijë? Sa vite do t'i kishin sot, 1432 fëmijë shqiptarë, ata shpirtra, të vrarë dhe të zhdukur në gjenocidin serb, të masakruar së bashku me nënat e tyre, sikur edhe Diturie Deliu pesëjavëshe, fëmijët e familjes Jashari dhe kështu me radhë? Apo, me çfarë t'i krahasojmë gratë shqiptare shtatzënë, të cilave, u është nxjerrë me thikë fëmija nga barku, pastaj, të vrarëve, të cilëve, u është nxjerrë zemra, vrasjet, dëbimet masive, si dhe, përdhunimi, në masë, i motrave tona nga barbarët serbë? E tillë ishte dhe, edhe sot, është Serbia Ruse, shtet dhe popull i cili, hapur, e rrezikon paqen, sigurinë, jo vetëm në Veri të Kosovës! Serbia po armatoset, po përgatitet për luftë dhe jo për paqe. Të gjithë ata, pra, edhe diplomatë evro-perëndimor, të cilët mendojnë ndryshe, madje, të cilët, po e përkrasin Serbinë, janë në lajthitje historike! Mbi këtë pikëvështrim, më lejoni të veçoj, disa theksa nga Kapitulli IX i librit të profesor Arsim Bajramit, që mban titullin, Themelimi i Gjykatës Speciale, si tendencë politike e relativizimit të gjenocidit serb në Kosovë. Themelimin e Gjykatës Speciale, autori e kupton, si tendencë politike të relativizimit të gjenocidit serb në Kosovë, akt politik. Ngritjen e aktakuzës,

kundër krerëve, çlirimtarëve të UÇK-së duhet kuptuar si, një mashtrim të madh, të Raportit të Dick Martyt, konspiracion politik serbo - rus, ndaj shtetit të Kosovës, madje, edhe përpjekje për ta rishkruar historinë e luftës së Kosovës 1998-1999. Ndaj, meqë, fabrikimi i gënjeshtërsë shekullit, të Dick Marty dhe në bashkëpunim me aleatët e tij, Serbinë dhe Rusinë, doli të jetë një falsifikim monstruo, një “përrallë e frikshme”, do të thoshim, “përrallë e Verdhe”, atëherë, Asambleja e Përgjithshme do të duhej ta miratonte një Rezolutë të re, me të cilën do të distancohej nga Raporti i Dick Martyt, posaçërisht, për mashtrimin, falsifikimin e Martyt për gjoja, “trafikim” të organeve njerëzore! Profesor Bajrami, udhëzon që, Kuvendi i Kosovës të miratojë një Rezolutë në të cilën, do të kërkojë nga Këshilli i Evropës, distancim nga mashtrimet, falsifikimet e komplotistit, Dick Marty dhe të shtetit serb! Dick Marty, duhet të ndiqet penalisht nga gjyqësia e Kosovës, njëjtë edhe shteti serb, nga gjyqësia ndërkombëtare! Ushtria Çlirimtare e Kosovës, ndërsa, duke krijuar aleancë ushtarake dhe diplomatike me NATO-n dhe me ShBA-të, ka zhvilluar luftë çlirimtare, të njohur, të pranuar, të përkratur, të mbështetur ndërkombëtarisht, me të gjitha ligjet e luftërave të drejta, mbrojtëse, pra, edhe me kodet e traditës dhe të kulturë shqiptare. Themeluesit, prijësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, disa prej të cilëve, padrejtësisht, nuk janë në Kosovë, i dolën përballë historisë, e përcaktuan drejtimin e saj, të ardhmen e lirisë së Kosovës! Në mënyrë të veçantë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, secili luftëtar i saj i bekuar, është vënë në mbrojtje të secilit banor paqedashës të Kosovës, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, duke përfshirë, edhe serbët kosovarë. Ky fakt, para qytetërimeve të shekullit XXI, luftën e popullit të Kosovës, nën drejtimin e çlirimtarëve tanë, e bën edhe më fisnike, përherë të lavdishme. Libri i prof. Arsim Bajramit dëshmon se e ardhmja nuk mund të ndërtohet pa të kaluarën, në rastin tonë pa kultivimin, afirmimin dhe mbrojtjen e vlerave më sublime të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të lirisë. Vlerat e luftës çlirimtare të popullit tonë, na forcojnë bindjen se, vendi ynë, Republika e Kosovës, pikërisht, përmes luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte dhe është, krenaria, dinjiteti, nderi shqiptar!

24 vjet më parë regjimi serb iku nga Kosova, mori me vete mbi 1 000 pengje shqiptare



Shkruan: Sadik ZEQRIRI

Sot, më 9 qershor 2023, bëhen 24 vjet që nga nënshkrimi i marrëveshjes ushtarako-teknike të Kumanovës, me të cilën iu dha fund luftës në Kosovë, duke u dorëzuar ish-ushtria e Jugosllavisë dhe kapitullimi i kasapit të Ballkanit, Slobodan Millosheviq. Kjo marrëveshje është arritur pas fushatës së bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe, e cila ka zgjatur për 78 ditë me radhë. Me këtë marrëveshje Serbia është detyruar t'i tërheqë të gjithë personat dhe organizatat me aftësi militare, përfshirë armatën e rregullt dhe forcat e marinës, civilë të armatosur, paramilitarë, forcat ajrore, gardën kombëtare, policinë kufitare, rezervistët, policinë ushtarake, shërbimet informative, MUP-in, policinë lokale, speciale, antirebeliste, antiterroriste dhe çdo grup të përcaktuar kështu nga KFOR-i. Po ashtu, u caktua një zonë sigurie ajrore 25 kilometra përtej kufirit të Kosovës si dhe u caktua një zonë prej 5 kilometrash përtej kufirit me RFJ-në që nuk guxonte të vendoste armatime të rënda dhe ushtri, përveç ushtarët kufitarë.

Më 12 qershor të vitit 1999 në Kosovë kanë zbarkuar trupat e para të këmbësorisë së NATO-s, ndërsa ka nisur largimi i forcave serbe. Marrëveshja e Kumanovës, ndërmjet NATO-s dhe RFJ-së, e nënshkruar më 9 qershor 1999, hyri në fuqi më 11 qershor 1999. Atë e nënshkruan

Michael Jackson, komandanti i parë i KFOR-it në Kosovë, dhe ish-shefi i Shtabit të Armatës Serbe, gjenerali Nebojsa Pavković, më pas i akuzuari i Hagës për krime lufte dhe gjenocid.

Por çfarë ndodhi me ish-të burgosurit të cilët mbaheshin nëpër burgjet e Kosovës?

Ishte data 9 qershor kur në dhomën nr. 2 në katin e parë të Pavijonit B, në Burgun e Lipjanit, hyri një gardian serb që ditë më parë na kishte treguar se është nga qyteti i Leskovcit. Ai na urdhëroi që t'i dorëzonim gjësendet që i kishim të fshehura nëpër rrobat tona. Ne që ishim të burgosur të vjetër, nuk kishim as lidhëse të këpucëve, ndërsa një grup prej 150 të burgosurve shqiptarë nga Gjakova, të cilët i kishin arrestuar në maj të vitit 1999, kishin deviza (marka) me vete. Urdhri ishte i prerë nga gardiani: Çka të keni të fshehura t'i hidhni në kapelën e një të burgosurit të Gjakovës, në kapelën e Mehdi Ferizit. Ne në dhomë ishim nja 30 të burgosur, pesë nga ne ishim me një stazh më të gjatë në burgje dhe, siç tregova më lart, nuk kishim asnjë kacidhe, ndërsa grupi i të burgosurve gjakovarë nga frika filluan t'i dorëzojnë markat. Aty u dorëzuan mbi 10 mijë marka gjermane, aq sa kishin. Kur hyri gardiani në dhomë për të shikuar se a e kemi zbatuar urdhrin e tij, nga gëzimi që pa shumë marka në tokë (kapela ishte mbushur plot marka), filloi t'i mbushë xhepat me marka dhe na urdhëroi të dalim të pimë

ujë, edhe pse nuk kishim kërkuar ujë. Sa herë kërkonin të dilnim për të pirë ujë ose për të shkuar në WC, na rrihnin gardianët, kështu që, edhe pse kishim nevoja fiziologjike dhe etje, duronin shumë që të mos dilnim.

Ne dolëm jashtë në korridor, aty ku gardiani i "pasur" tanimë, na dha lajmin se po ndalet lufta sepse po bëhet një marrëveshje në Kumanovë të Maqedonisë. Ne ishim të befasuar me këtë informatë dhe nuk dinim a të besonim apo jo, megjithatë filluam të besojmë sepse gardiani nuk kishte arsye të na jepte atë lajm të gëzuar. Ne aty vetëm rrahje, dhunë e maltretime kishim çdo ditë. Pasi i kthyen në dhomën tonë të vogël 30 të burgosur, u afrova te dritarja dhe pashë që në pavijonin tjetër përballë nesh kishte edhe të burgosur të tjerë shqiptarë që pritnin ndonjë lajm nga të burgosurit ordinerë të cilët punonin nëpër oborrin e burgut etj. Unë e hapa dritaren dhe komunikova me Demir Limën në distancë me zë të vogël, mjaftueshëm sa për ta dëgjuar informatën time. I thashë: "Gardiani na tha po mbaron lufta. Ishte arritur një marrëveshje në Kumanovë të Maqedonisë". Demiri ua komunikoi informatën shokëve në dhomë, më pas informata mori dheun, u përhap nëpër të gjitha dhomat e burgut. Më vonë një i burgosur kishte kërkuar të shkante në banjë. Ai ishte në katin e dytë në pavijonin përballë nesh. E hapi dritaren e


banjës, na dha edhe ai lajmin që ishte përhapur, megjithatë lajmi burimin e kishte nga dhoma nr. 2.

Ajo ditë deri në mbrëmje ishte e qetë. Nuk na rrahu askush. U bë ora e pasdites dhe u ndërruan gardianët. Iku edhe gardiani i "pasur", erdhën të tjerët. Pas mesnatës hyri dhunshëm nëpër dhoma një grup i gardianëve dhe na morën dy të burgosur, mua dhe Agron Sylën, na i lidhën duart me konop dhe na qitën jashtë dhomës për të na dërguar në pavijonin tjetër. Gjatë rrugës na rrahën sa mundën. Kjo ishte rrahja e fundit që përjetova në Burgun e Lipjanit. Ata na dërguan në një dhomë sepse kishin filluar t'i bënin listat për të na transferuar dhe një autobus kishte vend edhe për ty të burgosur. Kur na kanë larguar nga dhoma ishin dëgjuar dy krisma pushkësh dhe shokët e dhomës kishin menduar që na kanë vlarë, ashtu na thanë kur i takuam në Burgun e Nishit.

Në dhomën që na futën i pamë të gjithë të burgosurit me duar të lidhura pas shpinës. As ata nuk e dinin se çfarë po ndodhte. Mendonim se nëse ka zhvillime pozitive na largojnë nga Kosova e na dërgojnë në Shqipëri. Thoshin që më Dubrava nuk përsëritet, se tanimë Serbia s'ka çka të na bëjë më shumë dëme. U bë mëngjes. Na urdhëruan ashtu dy nga dy të dilnim nga dhomat e burgut. Gardianët kishin bërë një kordon të zakonshëm. Nuk na rrahën, vetëm na urdhëruan që me kokë poshtë e me duar pas shpinës të

vraponim për në autobusë. Një djalë që ishim bashkë të lidhur më tha se po na dërgojnë për Shqipëri. E ngrita kokën pak dhe pashë që në autobusë shkruante "Llasta" dhe "Express". Kishin tabela të Nishit e Beogradit. Nuk ia prisha dëshirën bashkëvuajtësit tim, por realiteti që po ndodhte ishte tjetër. Na hipën në autobus, ndërsa para detyrë të Burgut të Lipjanit, jashtë rrethojës, përpos plot autobus, pamë edhe shumë ushtarë e mjete motorike të cilët dukeshin që po niseshin për ndonjë rrugë të gjatë. Ashtu ndodhi. U nisën autobusët dhe në mes të çdo autobusi, edhe nga një automjet ushtrie. Autobusi mori rrugën për Prishtinë. Aty e kuptuam që po na dërgojnë për Serbi. Gjatë gjithë rrugës kishte traktorë, vetura, kamionë, autobusë, tanke e mjete të tjera të cilët i kishim mbushur me plaçka të shqiptarëve dhe po e lëshonin Kosovën e bashkë me ta edhe në pengjet e luftës e lëshonin Kosovën jo me dëshirën tonë, për t'u kthyer pas dy e më shumë vjetësh prapë në vendlindjen tonë, në Kosovën e çliruar. Në Burgun e Lipjanit ishim të gjithë ish-të burgosurit që kishim përjetuar masakrën e Dubravës, por kishte edhe të tjerë të burgosur që i kishin arrestuar pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, mbi caqet serbe në Kosovë e Serbi.

(Autori është ish-ushtar i UÇK-së, ish-i burgosur, i mbijetuar i masakrës së Dubravës)



Giresse: Duhet fokus maksimal për ta marrë maksimumin

“Dardanët” do të zhvillojnë dy përballje kualifikuese në këtë muaj ndaj Rumanisë dhe Bjellorusisë. Përzgjedhësi Alain Giresse ka kërkuar fokus maksimal në këto dy përballje për ta marrë maksimumin. Kosova është pjesë e Grupit I dhe në dy ndeshjet e para ka regjistruar dy barazime

EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll i zhvillon dy ndeshje kualifikuese për “Euro 2024” ndaj Rumanisë dhe Bjellorusisë. Përzgjedhësi i “dardanëve”, Alain Giresse, në konferencën e organizuar të premtën ka kërkuar fokusim maksimal nga ekipi i tij për dy ndeshjet e këtij muaji. Strategu francez ka bërë thirrje që të mendohet sa më pak për dy ndeshjet e kaluara dhe fokusi të jetë pikërisht në ndeshjet ndaj rumunëve dhe bjellorusëve. “Nuk do koment fakti se këto dy ndeshje janë shumë të rëndësishme. Ajo çfarë do të bëjmë për këto dy përballje është të tentojmë të mendojmë

sa më pak për atë çfarë ka ndodhur në të kaluarën. Do të mobilizohemi të përgatitemi sa më mirë. Ju u referoheni dy ndeshjeve të kaluara që u mbyllën baras kur thoni se kishim dy rezultate negative, por unë nuk e konsideroj se rezultati me Izraelin ishte negativ, nëse po ai me Andorrën. Prandaj duhet të fokusohemi dhe të shohim përpara”, ka thënë Giresse, i cili shpreson të nxirret maksimumi nga këto dy përballje. Sipas Gireses, grumbullimi i “dardanëve” është duke u zhvilluar në mënyrë progresive, teksa ende nuk e kanë filluar punën 100 për qind për shkak se disa prej lojtarëve nuk kanë arritur ende.

Në këtë konferencë Giresse



është përgjigjur edhe për mosgrumbullimin e disa futbollistëve si Florent Hadërgjona, Valon Berisha, Arbër Zeneli, Zymer Bytyqi, Arbnor Muja e Mirlind Daku. “Lista prej 23 lojtarëve është e limituar dhe më takon mua ta bëj përzgjedhjen që mendoj se është më e mira. Gjithmonë ka kërkesa ose pyetje pse dikush bën pjesë në listë e pse dikush jo. Herën e fundit kishte pyetje për Ermal Krasniqin. Ai sot është pjesë e grumbullimit. Por, gjithmonë varet nga pozicioni ku lojtarët luajnë. Kjo është

arsyeja pse janë penalizuar disa lojtarë, ngaqë në sulm kemi shumë lojtarë, derisa në repartin e mbrojtjes jemi më të kufizuar”, ka deklaruar Giresse, i cili ka folur edhe për rastin e Arbnor Mujës. Sipas tij, futbollisti që e fitoi titullin në Belgjikë fillimisht nuk ka ardhur në ndeshjet miqësore të vitit të kaluar, pastaj ka qenë pjesë e grumbullimit në dy ndeshjet e marsit, teksa këtë herë lojtari ka kërkuar garanci nëse do të jetë titullar. “Unë i kam shpjeguar se askush nuk e ka vendin e sigurt në ekip dhe nëse ai mendon kështu, atëherë

më mirë të mos vijë fare”, ka shtuar Giresse.

Ditët e fundit është folur se Muja do t'i bashkohet Kombëtares së Shqipërisë. Lidhur me këtë temë, menaxheri i Përfaqësueses së Kosovës, Bajram Shala, ka thënë se këto janë spekulime dhe se kjo nuk është hera e parë që Kosova po shantazhohet në mënyra të tilla. “Situata e Mujës është shumë e thjeshtë dhe të gjitha ato lajme në medie rreth tij janë spekulime. Ai ka qenë që një kohë të gjatë te Kosova në të gjitha grupmoshat dhe mbetet futbollist i Kosovës. Por, shqetësues është fakti se ky është një lloj trendi që vazhdimisht ka qenë vitet e fundit, ndoshta që nuk vjen nga futbollistët, por nga agentët e tyre, duke bërë shantazh që sa herë nuk ftohet një lojtar, atëherë flitet se do të shkojë diku tjetër. Por, ne nuk pranojmë shantazhe të tilla”, ka thënë Shala.

Kosova më 16 qershor në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë e pret Rumaninë, kurse tri ditë më pas do të përballet me Bjellorusinë.

Tovërlani publikon listën e futbollistëve për ndeshjen kundër Estonisë

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës U21, Afrim Tovërlani, e ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për ndeshjen e parë kualifikuese për “Euro 2025” kundër Estonisë, e cila do të zhvillohet më 20 qershor në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë.

Përfaqësuesja U21 i fillon të shtunën përgatitjet për këtë ndeshje, teksa stërvitja e parë mbahet në orën 17:00 në Kampin Nacional në Hajvali.

Në listën e Tovërlanit janë plot shtatë futbollistë nga Albi Mall Superliga e Kosovës. Altin Gjokaj (Drenica), Eron Isufi dhe Ardit Tahiri (Drita), Lindon Emerllahu (Ballkani), Lulzim Peci (Trepça '89), Etnik Brruti (Malisheva) dhe Oltion Bilalli (Gjilani) janë emrat e të ftuarve.



Lista e futbollistëve: L. Besson, A. Gjokaj, E. Isufi, L. Sahitaj, V. Statovci, A. Hoti, A. Hasani, V. Zumberi, A. Pacolli, F. Haxha, E. Rexhaj, E. Letaj, A. Podrimaj, L. Emerllahu, A. Smakaj, L. Simnica, L. Peci, E. Brruti, M. Avdyli, O. Bilalli, B. Zeneli, A. Llugiqi, A. Tahiri, D. Krasniqi.

Drita transferon Thaqin nga Ballkani

GJILAN, 9 QERSHOR - Nënkampionia e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, pas largimit të disa futbollistëve, ka arritur ta bëjë transferimin e parë për edicionin e ri futbollistik. Ish-mbrojtësi i Feronikelit, Astrit Thaqi, ka vendosur të largohet nga Ballkani dhe t'i bashkohet skuadrës gjilnase. “Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë që kemi arritur marrëveshje me mbrojtësin Astrit Thaqi. Sot në ambientet e klubit Thaqi është prituri nga drejtori sportiv i klubit, Valon Zumberi, i cili i ka uruar mirëseardhje në familjen bardh e kaltër dhe ka



nënshkruar kontratë dyvjeçare me klubin. Thaqi ka përvojë të gjatë në Superligë si dhe në arenën ndërkombëtare. Astriti është paraqitur për shumë skuadra të Kosovës, së fundmi ishte pjesë e KF Ballkani. Mirë se vjen, Astrit!”, thuhet në njoftimin e FC Drita.

FHK-ja: Edicioni 2022/2023, i suksesshëm

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës. Nën drejtimin e presidentit Eugen Saraçini bordi analizoi kampionatin që tashmë ka përfunduar dhe mori vendime të rëndësishme.

Edicioni 2022/2023 është vlerësuar shumë i suksesshëm, ndërsa është premtuar angazhim maksimal për avancim të mëtejshëm. Ndërkohë, sipas autorizimit nga Kuvendi i fundit i Punës, bordi mori vendim që sistemi i garave të

mbetet ai që ishte në edicionin 2022/2023. Ky vendim u mor pas një diskutimi të gjerë, ku kishte argumente për dhe kundër. Bordi i Federatës së Hendbollit ka shqyrtuar dhe ka aprovuar raportin e Komisarit të Garave. Është vlerësuar puna e komisarit

Isak Osmani dhe u vendos që t'i besohet detyra e ndjeshme edhe në edicionin e ardhshëm garues, 2023/2024.

Bordi i FHK-së, po ashtu, mori vendim që afati i rregullt kalimtar të fillojë më 15 qershor dhe të përfundojë më 15 korrik.



FC Ferizaj: Panadiqi do të mbetet pjesë e rëndësishme e historikut të klubit

FERIZAJ, 9 QERSHOR - Andrej Panadiq nuk do të jetë trajner i Ferizajt për sezonin e ardhshëm. Lajmin e ka dhënë vetë Klubi i Ferizajt përmes një njoftimi në faqen zyrtare. Largimi i tij vjen pasi Ferizaj nuk arriti ta siguronte qëndrimin në Superligën e Kosovës, pasi u mposht nga Liria

në ndeshjen e barazhit pas ekzekutimit të penalltive. "FC Ferizaj njofton se ka ndarë rrugët me trajnerin kroat Andrej Panadiq dhe zëvendësin e tij Nikola Boroe. Panadiq ishte në krye të shtabit teknik tash e shtatë muaj, ku në sezonin pranveror, nën drejtimin e tij, skuadra arriti

t'i mbledhë 28 pikë. Andrej ishte fjalëpakë e punë shumë. Një mentalitet i futbollit kroat, bazuar në kërkesën kryesore të tij, përgjegjësi nga secili lojtarë në fushën e lojës. E mori ekipin në një gjendje të vështirë, kur pakkush mund të besonte se do ta kapnim barazhin. Pavarësisht

që misioni nuk përfundoi me sukses, Andrej Panadiq do të mbetet pjesë e rëndësishme e historikut të klubit tonë", thuhet në njoftimin e klubit që ka rënë në Ligën e Parë. FC Ferizaj në fund e falënderoi trajnerin Panadiq, kurse ka lënë mundësinë e hapur që rrugët



mund të bashkohen sërish në të ardhmen.

Sadiku: E prisja rikthimin në Kombëtare, kam besim për Evropian

TIRANË, 9 QERSHOR - Sulmuesi Armando Sadiku u rikthye në Kombëtare dhe në konferencën për shtyp para medieve u shpreh shumë i lumtur, duke shtuar se shanset për Evropian janë të shumta. "E prisja që do të më thërriste. Qëkur u emërua më ka telefonuar dhe kemi folur. Jam shumë i lumtur sepse e prisja prej kohësh. Ka çuna të rinj. Disa i njoh, por ka edhe të rinj megjithëse edhe këta i njoh. Kualiteti është i madh dhe jemi të gjithë bashkë për një qëllim dhe jam shumë i kënaqur që do ta jap kontributin tim në Kombëtare. Jam i lumtur dhe e kam vlerësuar Silvinjon pasi më thirri direkt pas firmës. Më ka treguar se do të jem i rëndësishëm në ekip dhe do të jem në dispozicion në çdo moment që do të ketë nevojë për mua. Shpresoj ta shpërblej në fushë vlerësimin që ka për mua", ka thënë Sadiku, i cili ka folur edhe për të ardhmen e tij në nivel klubesh. "Te Kartagjena kisha një vit kontratë. Ata



më propozuan të njëjtën kontratë siç e kisha pasi janë kënaqur. U kam kërkuar kohë pasi erdha në Kombëtare dhe pasi të përfundoj këtu, do të vendos. Po shoh sepse kam edhe oferta të tjera dhe në fund do të vendos", ka shtuar ai. Sulmuesi Armando Sadiku ka vlerësuar se Shqipëria ka shumë kualitet në mesfushë. Ai e ka vlerësuar Moldavinë si një ekip të fortë dhe do të rrijë në mbrojtje, por ka premtuar se do ta japë maksimumin për t'i shfrytëzuar

rastet që krijohen dhe të shënojë gol. Në fund sulmuesi kuqezi foli edhe për mundësinë që Shqipëria të kualifikohet në Kampionatin Evropian dhe tifozët kuqezi. "Jam shumë i bindur dhe kam besim. Nuk ka ekipe të dobëta, por grupi na lejon ta arrijmë qëllimin. Nëse kemi edhe mbështetjen e tifozëve dhe me Moldavinë e nisim me këmbën e mbarë, e arrijmë qëllimin dhe shpresoj ta arrijmë e të jem sërish protagonist. Pa ta nuk do të shkonim. Gjithmonë jepnim 100%, por pa mbështetjen e tyre dhe pritjen që na bënin, nuk e arrinim. U bëj thirrje të gjithëve që të na mbështetnin sepse kemi nevojë dhe ua shpërblejmë në fushë dhe fitojmë. Shpresoj ta kthejmë atmosferën e 2016-s. Konkurrenca është e mirë sepse mundohesh të mos gabosh. Ne jemi futbollistë dhe pranojmë zgjedhjet e trajnerit dhe kur na jepet mundësia duhet ta japim maksimumin tonë", ka deklaruar Sadiku.

Arabia Saudite prish renditjen e lojtarëve më të paguar, Mbappe zbritet i pesti



Riyadh, 9 qershor - Nëse një vit më parë Kylian Mbappe u bë më i paguari në botë me rinovimin e kontratës te PSG-ja, ai tashmë ka zbritur në vendin e katërt. Transferimet e jave të futbollit jashtë Evropës kanë bërë që renditja të pësojë ndryshime. Në vendin e parë tashmë gjendet Cristiano Ronaldo, që me kontratën që firmosi në janar te Al Nassri në Arabinë Saudite, përfiton rreth 200 milionë euro në vit.



Në vendin e dytë ka kaluar Karim Benzema, që do të marrë sa gjysma e Ronaldos në skuadrën tjetër arabe Al-Itihad, që u shpall kampion. Ngjitja galopante i takon Ngolo Kante, i cili do të luajë po në kampionatin e Arabisë Saudite dhe paga e tij do të jetë 50 milionë euro. Pra, Arabia Saudite ka prishur ekuilibrat e tregut të futbollistëve, me shumë yje të tjerë që janë në fund të karrierës që pritet t'i bashkohen këtij

trendi. Në vendin e katërt të renditjes për pagat më të lartë është Lionel Messi, që do të paguhet rreth 50 milionë euro tek Inter Miami. Po kaq edhe Mbappe, që nga i pari zbritet në vendin e pestë.

Top-dhjetëshja plotësohet nga yje të tjerë, Haaland i gjashti me 45 milionë euro, Salah 35 milionë, Neymar 30, Iniesta 28 dhe De Bruyne 21 milionë euro në vit.

Renditja e lojtarëve më të paguar

1. Cristiano Ronaldo	200 milionë euro në vit
2. Karim Benzema	100
3. Ngolo Kante	50
4. Lionel Messi	50
5. Kylian Mbappe	50
6. Erling Haaland	45
7. Mohamed Salah	35
8. Neymar	30
9. Andres Iniesta	28
10. Kevin De Bruyne	21

Nesta: Shkarkimi i Maldinit është përtej çdo logjike

Legjenda e Milanit, Alessandro Nesta, ka kritikuar vendimin e drejtuesve të klubit për shkarkimin e Paolo Maldinit. Drejtorët, Maldini dhe Ricky Massara, u shkarkuan nga pronari i Milanit, Gerry Cardinale, këtë javë, pas një

debati që kishin mes vete. Shkarkimi i dy drejtuesve të cilët sollën yje të "Rossonerët" dhe titullin kampion pas më shumë se një dekade, ka marrë shumë kritika nga figura të njohura. I fundit që ka kritikuar shkarkimin e legjendës së klubit,

Maldini, është ish-bashkëlojtari i tij, italiani Nesta. "Shkarkimi i Maldinit nga Milani? Nuk kam dëgjuar nga ai, ai do ta bëjë më vonë, por është një situatë jashtë çdo logjike", ka thënë Nesta për "Sky Italia". "Pronarët e huaj janë të mirëprirur në Itali sepse sjellin

para të reja, por duhet ta studiojnë më mirë historinë e klubeve, të dinë se çfarë kanë fituar, çfarë përfaqësojnë personazhe të caktuara, çfarë duan njerëzit. Për më tepër, Maldini e riktheu Milanin, në gjendje të egër, për të fituar

'Scudetto' dhe për të luajtur në një gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve; ai ka një personalitet të fortë, pas gjithë këtyre viteve ai ende më mahnit, por ai nuk është kokëfortë dhe ai e tregoi këtë duke mos thënë asgjë për të", ka shtuar Nesta.

SHKURT

Laimer, përforcimi i parë i Bayernit

Bayern Munchen ka njoftuar se e ka sjellë përforcimin e parë për sezonin e ardhshëm. Konrad Laimer, mesfushori qendror që ka luajtur me Leipzigun dhe do të mbërrijë më 1 korrik te "bavarezët" pasi t'i mbarojë kontrata aktuale më 1 korrik. 26-vjeçari austriak ka nënshkruar një kontratë me kampionët e Bundesligës deri në vitin 2027. Këtë sezon me Leipzigun, Laimer është aktivizuar në 29 ndeshje, ku ka shënuar 4 gola dhe ka asistuar një herë.

Përcaktohen dy finalistet e Roland Garros

Tenistja polake Iga Switek, numri 1 në botë dhe ajo çeke Karolina Muchova, numri 43, janë dy finalistet e grand slamit të Roland Garros. Ky është turneu më i madh i fushave me dhe që luhet në Paris. Finalja do të luhet ditën e shtunë. Në gjysmëfinalen e parë Swiatek mundi 2-0 (6-2, 7-6) rivalen braziliane B. Haddad Maia, që ishte surpriza e këtij turneu. Një fitore e merituar e polakes, që në setin e parë dominoi në lojë, por në të dytën vuajti shumë për të mundur amerikano-latinen në "tie break". Surprizë edhe dalja në finale e tenistes çeke Karolina Muchova, që mundi 2-1 (7-6, 6-7, 7-5) bjellorusen Aryna Sabalenka, numrin 2 në botë. Kjo e fundit ishte favorite, por nuk arriti ta fitojë ndeshjen, që ishte mjaft e fortë, me emocione dhe ku çdo set u vendos në pikët shtesë.

De Bruyne: Askush nuk beson se do të jetë e lehtë kundër Interit

Mesfushori i Manchester Cityt, Kevin De Bruyne, dha një intervistë për "Gazzetta dello Sport", ku foli për finalen e nesërme të Ligës së Kampionëve kundër Interit. Fantazisti belg u shpreh se Interi është një ekip mjaft i fortë dhe jo më kotë është në finale. "Nuk mund të arrish në finalen e Ligës së Kampionëve nëse nuk je një ekip i fortë. Interi fitoi Coppa Italia, triumfoi pothuajse në çdo ndeshje në fund të sezonit. Është një ekip me një identitet të qartë, një formacion të mirëpërcaktuar dhe stil loje: Atë që bën, e bën shumë mirë. Askush nga ne nuk beson se do të jetë e lehtë kundër Interit. Dhe pastaj është një finale, gjithmonë fillon me të dy skuadrat që kanë të njëjtat shanse", ka thënë De Bruyne.

Formula 1 do të zbarkojë në shtetin afrikan

Formula 1 vijon të mbetet në kërkim të horizonteve të reja dhe ideja e fundit më e çmendur është ajo e zhvillimit të një gare në Zanzibar, shtetin e varfër afrikan, por mjaft të njohur për plazhet magjepsëse. Sipas "SportsSceda", në këtë shtet kanë gati një projekt për ta realizuar atë, duke shpenzuar 500 milionë euro për ta konkretizuar atë. Ky projekt ka marrë miratimin e qeverisë dhe të pushtetit lokal, ndërkohë që edhe disa ish-pilotë të Formulës 1 po e mbështetnin atë. Zëdhënësi i projektit, Salim Turkey, u shpreh: "Jemi të lumtur e të nderuar që presidenti i Zanzibar dhe qeveria jonë e kanë mbështetur e miratuar këtë projekt. Ky është një projekt që synon ta sjellë Afrikën dhe Zanzibarin në skenën botërore të turizmit dhe shërbimeve të ndryshme". Për momentin nuk ka ende afate në lidhje me debutimin e kësaj gare në Botërorin e Formulës 1 apo për llojin e pistës, që me shumë gjasa do t'i prekë zonat më ekzotike të kësaj ngjarje.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Te Arbeni SH.P.K shpall te pavlefshme certifikatën e TVSH-se si dhe certifikatën e biznesit me nr: 811421677.

- Aysel Kirkul shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Emin Duraku " Prizren.

- Muhamet Zherka shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Leon Kuqanaj shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEFCI".

- Albana Peci shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 te shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- "Auto Geti 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- Kosovare Imer Hasanaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Edukimit në UP "Hasan Prishtina" Prishtinë, Bachelor për shkak të gabimit teknik Kimi –Fizik duhet të jetë Fizik-Kimi me nr. 1243.

- Ilir Sadrijaj nga Gramaçeli, komuna e Deçanit shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makinerisë Gjakovë.

- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- Enver Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIIIshfmu "Fadil Hisari" Prizren.

- CelebicEsef shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- XhelalFerizi shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

- Valmir Kadrija shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

- Veton Aliu, shpall te pavlefshme dëftesën e 11 klase te shkollës se mesme "ARKITEKT SINANI".

- Bleona Binaku, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "FRANG BARDHI".

- Merlind Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Remzi Kida nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Flamur Godeni nga Gajkova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mishi pule



cilësi e garantuar

pa konservues